



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

Procesverbal nga mbledhja e XXV-të (njëzetepesë - mandati VII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 06 shtator 2024.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, dhe filloi në orën 10;15

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: znj.Qëndresë Hajrizi, z.Florent Hasani, z.Arbnor Fazliu, znj.Shkurte Sejdiu, znj.Sevdije Mustafa, z.Selver Rama, z.Demokrat Hodolli, znj.Fikmete Qurkolli.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe Xhevat Llugaliu udhëheqës i sektorit të arsimit –DKA; Liman Zeqiri-shef i Zyrës Komunale për Komuniteteve dhe Kthim ZKKK; Përparim Shala përfaqësues i OSBE; Shefqet Ismajli përfaqësuesi i policisë; Tamas Pap përfaqësues i KFOR.

Rendi i ditës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit duke i'u dëshiruar punë të mbarë, ndër të tjera, theksoi, thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje besoj e kenë marrë me kohë, andaj në vazhdim po i lexoj rendin e ditës dhe njëkohësisht pyes nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim rendin e ditës.

Njëzëri me 9 vota Për, nga të gjithë anëtarët sa ishin prezent miratohet rendi i ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 05 gusht 2024

Njëzëri, pa plotësim ndryshime apo vërejtje eventuale, miratohet Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e datës 05.08.2024.

2. Informatë e Drejtorisë së Arsimit për fillimin e vitit të ri shkollor 2024 / 2025, me theks të veçantë vijueshmëria e nxënësve të komuniteteve jo shumicë, shqetësimet eventuale të tyre sa i përket pajisjes me libra mësimore, mundësisht përfshirë edhe nxënësit e shkollave të mesme të larta.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës fjalën ia kaloj z.Xhevat Llugaliut përfaqësuesit të drejtorisë së arsimit - DKA.

z.Xhevat Llugaliu, udhëheqës i sektorit të arsimit -DKA, theksoi, mund t'ju njoftoj se viti shkollor 2024-2025, ka filluar mbarë dhe mirë, në bazë të informacioneve që kemi përmes platformës prindërit i kanë siguruar mjetet për blerjen e librave, kemi disa ankesa se disa libra nuk gjinden në shitje. Sa i përket drejtorisë ne kemi bërë të gjitha përgatitjet, më datë 04.09.2024, kemi bërë përrurimin e dy shkollave të reja në fshatrat Dumosh dhe Obrançë, vlen të ceket se këto dy shkolla janë ndërtuar me investime të buxhetit të komunës, konkursi është shpallë me rregull,

kompletimi i kuadrit është bërë me rregull nuk kemi ndonjë vërejtje që do jepnim ndonjë sqarim dhe nëse keni ndonjë pyetje apo vërejtje ne mund t'ju përgjigjemi.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, faleminderit i nderuar për këtë informatë, unë dje si përfaqësues i komuniteteve kam vizituar shkollën “Ibrahim Rugova”, dhe tri shkolla tjera e posaçërisht jam interesuar për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë se këto proceset tjerat mësimore janë në rregull dhe se di a ka ndonjë problem. Sipas informatave që kam marrë unë i falënderoj drejtorët e shkollave dhe drejtorin e DKA-së, se pa asnjë problem nxënësit e komuniteteve janë regjistruar në shkolla dhe dihet se në çdo vend ka probleme por me regjistrimin e nxënësve në klasën e parë nuk kemi probleme, kemi pas problem me një nxënëse që nuk din me fol mirë dhe prapë ajo nxënëse është regjistruar dhe ia kanë dhënë një asistent i cili tash do të merret me kujdesen e saj se aty ishin edhe disa nxënës të komunitetit shumicë që kishin të njëjtin problem dhe secilit nxënës ia kishin angazhuar nga një asistent që këta nxënës të arrijnë sukses. Një problem është pak shqetësues për komunitetin sepse kanë vështirësi për aplikim në program për blerjen e librave, ka pak prej tyre që dinë ta përdorin aplikacionin dhe shpesh herë na ka ndihmuar z.Agim Hyseni por këtë radhë nuk ka pas mundësi të na ndihmoj për shkak se ka bërë një ndërhyrje kirurgjike pra nuk është mirë me shëndet dhe ne kemi angazhuar një nxënës i cili sipas mundësive ju ka ndihmuar në aplikim. Një problem tjetër e kemi për fëmijët që nuk kanë prindër që për ta përkujdesen ose gjyshërit ose dajët dhe këta fëmijë nuk kanë mundësi me i marrë librat se sistemi nuk e pranon aplikimin e kujdestarit sepse në bazë të programit aplikues duhet të jenë prindërit kështu që ky problem prapë na është përsëritur. Vitin e kaluar jemi organizuar vetë dhe kemi mbledh disa para dhe ua kemi blerë librat nxënësve të komuniteteve jo shumicë por këtë vit nuk e di se si do të veprojmë, në Komunën e Podujevës gjithmonë nxënësit e shkollave të mesme librat i kanë marrë pas lufte prej komunës, komuna e ka pas një fond dhe ua ka nda librat, sivjet nuk e di a ka fond për blerjen e librat për nxënësit e komuniteteve jo shumicë të shkollave të mesme, vitin e kaluar nuk ka pas fond të tillë edhe pse kemi bërë kërkesë, ashtu siç e ceku zyrtari i DKA-së ky fillim vit mësimor ka filluar mbarë e mirë dhe urojmë të vazhdoj kështu e të na prinë e mbara me të gjitha të mirat.

znj.Sevdije Mustafa, theksoi, para jush po e ngrisë një shqetësim për dy ose tre nxënës të komuniteteve jo shumicë që kanë shpreh dëshirë të regjistrohen në shkollë në drejtimin e mjekësisë por nuk janë regjistruar, gjithherë ju kanë thënë se në atë drejtim s'ka vende, ata nxënës janë të shkëlqyeshëm, dua ta di a ka ndonjë mundësi të regjistrohen ata nxënës në drejtimin e mjekësisë.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, ne kemi bërë kërkesën te drejtori i DKA-së, dhe ka mbete që ai ta shqyrtoj kërkesën, ku atë kërkesë ai e ka përcjellë në ministri në Prishtinë dhe është kthyer ndonjë përgjigje nga ministria ne ene nuk e dimë por nxënësit kanë mbete pa u regjistruar, mirëpo e falënderoj z.Liman Zeqiri ku së bashku me të kemi përgatitur kërkesën dhe ia kemi dorëzuar drejtorit dhe e kemi bërë të pamundurën për regjistrimin e atyre nxënësve por tash qysh janë rregullat atje nuk e di por me të vërtetë ata nxënës kanë nevojë që të regjistrohen në drejtimin e mjekësisë. Dikush prej komunitetit duhet të regjistrohet në atë drejtim se kemi nevojë që së paku dy ose tre nxënës të regjistrohen në atë drejtim sepse të gjithë ne kemi nevojë për mjekësi edhe pse me të vërtetë ata nxënës ishin të shkëlqyer, se a do të regjistrohen ata nxënës nuk e di kjo mbetet të bisedohet edhe njëherë me drejtorin dhe nëse ka nevojë edhe njëherë edhe në Prishtinë shkojmë në nivelin qendror dhe shikojmë se si duhet veprojmë.

z.Liman Zeqiri -shef i Zyrës Komunale për Komuniteteve dhe Kthim ZKKK, theksoi, ne i kemi shqetësimet tona si ZKKK unë pajtohem plotësisht që vitin e kaluar ka pas probleme shumë për plotësimin e dokumentacionit që ka qenë online për t'i marrë librat por ju them që ka probleme

edhe te kompletimi i teksteve shkollore edhe nga komuniteti shumicë dhe kur është në pyetje shkolla nuk ndahen komunitetet por është problematikë kombinimi i librave sepse libraritë e ndryshme po i kombinojnë librat e ndryshëm e kjo është pak shqetësuese se pavarësisht të gjithave paraqet vështirësi në marrjen e librave. Unë e përgëzoj DKA-në se procesi mësimor ka filluar mirë e mbarë dhe dashtë Zoti të jetë vit i mbarë megjithatë kur ndalemi te komunitetet e di që vitin e kaluar ka pas disa raste ashtu siç i cekët ju kur dihet se për të aplikuar për fëmijët duhet të jen prindërit dhe normalisht se ka pas vështirësi në këtë proces të aplikimit se ka pas prej tyre që s'kanë ditë të aplikojnë e këtë shqetësim e ka pas edhe familja Behluli që kam intervenuar edhe këtë vit ku ju kam ndihmuar në aplikim tash është normale se ka evoluar teknologjia dhe ka disa individ që nuk din të aplikojnë në formë dhe mënyrën si duhet e në veçanti te komuniteti jo shumicë, megjithatë mbesim me shpresë që do të kompletohen tekstet shkollore. Atë që e cekët ju më herët unë jam prezent këtu dhe së bashku me ju i nderuari kryesues kemi qenë te drejtori i DAK-së, dhe janë tre nxënës që kanë konkurruar për tu regjistruar në drejtimin teknik, infermier në shkollën "Isa Boletini", mirëpo duhet të bëhemi të sinqertë se nganjëherë për një pikë bie nga testi pranues se nuk bëhet ai diferencimi askund dhe mundet të ankohet ai ose ajo që se ka arritur numrin e pikëve, ata nxënës janë të shkëlqyeshëm, nuk kanë vërejtje unë jam për t'i ndihmuar komuniteteve, drejtori e ka bë një shkresë të cilën i ka dërguar Ministrisë së Arsimit për ta rritur numrin e nxënësve në klasa, se di një klasë a i ka 28 nxënës dhe nuk e di a ka mundësi asaj klase t'i shtohen edhe 3 nxënës dhe këtë kërkesë drejtori ia ka bë ministrisë për hir të atyre nxënësve që mos të mbesim pa regjistruar në drejtimin e mjekësisë sepse edhe për neve kjo është vlerë dhe për komunitetin sepse mjekësia është një degë e veçantë e studimeve dhe është mirë se është një shembull për komunitetet e sidomos për atë jo shumicë. Ky është veç një sqarim, drejtori ka thënë që ata të regjistrohen në një drejtim tjetër për mos me mbet jashtë bankave shkollore e mundësisht pastaj ata nxënës të presin deri në një përgjigje nga ana e ministrisë qoftë pozitive për kthimin e tyre në drejtimin e mjekësisë, po dihet se për këtë drejtim janë disa kriteret dhe ne nuk mund të dalim jashtë atyre kriterëve edhe pse DKA-ja e ka bërë të pamundshmen për t'i përfshi edhe ata tre nxënës në drejtimin e mjekësisë. Mbes me shpresë që do të rregullohet ky proces por nganjëherë janë edhe afatet kohore e dihet tash se është muaji shtator që është fillimi i procesit mësimor por ne së bashku me ju duhet t'i shikojmë mundësitë që i kemi të regjistrohen në ato drejtimet që i meritojnë sepse për një ose dy pikë nuk mund të regjistrohen në drejtimin e mjekësisë sepse aty kanë qenë ato kriteret të përcaktuara në rezultate të caktuara, sukcesi dhe poentomi që bëhet në test kombëtar pastaj mblidhen pikët dhe del rezultati dhe aty nuk shkruan emri se kush është ai ose ajo edhe prej cilit komunitet vjen por ka vetëm emër dhe mbiemër dhe është normale që edhe në dokumentet identifikuese nuk përcaktohet kombësia por megjithatë ne e kemi detyrë si institucione si komunë ku edhe kryetari është angazhuar në këtë drejtim që t'i ndihmojmë, t'i fuqizojmë dhe t'ju dalim në ndihmë komuniteteve jo shumicë sepse e kemi edhe obligim si komunitet shumicë t'i ndihmojmë komunitetit pakicë. Këto janë ato që unë i di dhe mbes me shpresë që ndoshta ajo kërkesë e tyre mund të realizohet se i kam pas disa thirrje prej prindërve të atyre nxënësve por në bazë të mundësive tona ne mund vetëm të interferojmë ose ta plasojmë informacionin deri te organet përgjegjëse që merren me këtë çështje.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, kam edhe një pyetje për zyrtarin e DKA-së, a ka fond për blerjen e librave për nxënësit e komuniteteve pakicë për shkollat e mesme, vetëm dua ta di nga drejtori këtë që ta kem si informatë pastaj e shqyrtojmë këtë çështje.

z.Liman Zeqiri -shëf i Zyrës Komonale për Komuniteteve dhe Kthim ZKKK, theksoi, më parë janë marrë këto vlerësime dhe normalisht është bë ajo lista për shkollat e mesme të larta se për shkollat fillore është obligative pajisja me libra se dihet se nuk mund ta detyrosh askënd të shkoj

në shkollën e mesme të lartë, mirëpo ne duhet të angazhohemi që ata nxënës t'i vijojnë mësimet dhe e kemi obligim t'i ndihmojmë. Në kuptimin e ndihmesës ne ju kemi ndihmuar komuniteteve pakicë e këtë e dini ju kryesues se keni qenë çdo herë prezent me mua kur i kemi ndihmuar me mjete shkollore edhe disa nxënës të komunitetit shumicë që kanë qenë në gjendje të rëndë materiale ku më parë është bërë ajo listë prej 50-60 nxënës të të gjithë komuniteteve ku ju kanë siguruar tekstet shkollore. Tash shefi i DKA-së tha se do ia përcjellë këtë çështje drejtorit të DKA-së, dhe shpresojmë se kjo kërkesë do të shqyrtohet dhe zbatohet.

3. Informatë e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim për platformën e re nga Zyra e Kryeministrit - Zyra për Çështje të Komuniteteve për fuqizimin e tyre në resurse dhe mbështetje.

z.Liman Zeqiri -shef i Zyrës Komunale për Komuniteteve dhe Kthim ZKKK, theksoi, unë kam marrë pjesë drejtpërdrejtë në takime kur është hartuar kjo platformë, platforma është online dhe secili mund të ketë qasje, është zyra e kryeministrit apo zyra për çështje të komuniteteve, është një platformë e re shumë e mirë që këto temat që po i komentojmë të gjithë ata të interesuarit mund të kyçen në platformën e re të zyra e kryeministrit – zyra e komuniteteve. Në këtë platformë gjithçka është transparente secili prej komuniteteve jo shumicë mund ta shohë platformën dhe këtu çdo muaj është buletini vijnë gjitha kërkesat që janë në interes apo për fuqizimin e komuniteteve jo shumicë qoftë në shëndetësi, arsim, strehim, punësim, shkollim, bursa etj, ua japin adresat e sakta që ata mund të konkurrojnë kur dalin konkurset. Konkurset janë shumë transparente sidomos të pjesa më e ndjeshme të konkurset e punësimit qoftë në polici, organizata të ndryshme jo qeveritare, të gjitha në këtë platformë mund t'i gjeni, unë ju inkurajoj sepse është thjeshtë për me gjetë këtë platformë, zyra e kryeministrit – zyra për çështje të komuniteteve, platforma për fuqizimin e komuniteteve në të gjitha fushat, për atë ne edhe kemi biseduar dhe kemi mbajtur edhe fushata ku do të shfaqen edhe poster në të gjitha lagjet ku jetojnë komunitete jo shumicë në të gjithë Kosovën. Platforma është në 6 gjuhë, gjuhën shqipe, serbe, romë, boshnjake, angleze, turke, do të thotë secili mund ta gjej veten por ne e dimë se në komunën tonë flitet vetëm gjuha shqipe por pavarësisht prej asaj kjo platformë është prej zyrës së kryeministrit dhe secili në këtë platformë mund ta gjej gjuhën e vet dhe unë ju siguroj se në këtë platformë janë shumë transparente të gjitha kërkesat për punësim, shëndetësi, arsim, për organizim për shoqata për takime. Tash gjeneratat e reja mund ta gjejnë veten më lehtë sepse vetëm futen në platformë të qendra e informacioneve dhe aty janë aplikacionet për qasje të lehtë ku është rrjetëzimi me platformën ekzistuese ku aty ka informacione ku mund të përhapen edhe rrjetet dhe raportimet për të drejtat e njeriut ku çdo njëri mund të ankohet në qoftë se ju ka shkelur ndonjë e drejtë qoftë edhe çështja e këtyre nxënësve. Unë ju them se e drejta për shkollim është e drejta më sublime e njeriut e ata mund të ankohen se kanë ra nga testi për një pikë dhe unë jam i bindur se ajo pikë hiqet te komuniteti dhe ndihmohen ata nxënës, ky është një shembull shumë të thjeshtë që desha ta cek prandaj është mirë që kjo informatë rreth platformës së për fuqizimin e komuniteteve në kuadër të zyrës së kryeministrit.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, ju falënderoj shumë për këtë informatë të rëndësishme për komunitetin tonë, është mirë që komuniteti të informohet rreth kësaj platforme dhe problemet e tyre që i kanë t'i paraqesin drejtpërsëdrejti në platformë ku do i marrin përgjigjet e duhuram, prandaj është mirë që ne t'i kemi këto fletushkat e platformës që të kemi më të qartë informimin rreth saj.

4. Të ndryshme

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, unë kam marrë një ankesë prej z.Veli Halili, të cilin e njeh edhe z.Liman Zeqiri, atij i është ndërtuar shtëpia prej organizatave por e ka një problem për të cilin ka bërë edhe kërkesë në komunë mirëpo nuk ka marrë përgjigje sa i përket rregullimit të rrugës së tij në fshatin Dumnicë, pasi që shtëpinë e ka të ndërtuar në atë pjesë ku rruga kalon përmes arave prandaj kërkesa e tij është rregullimi i asaj rruge me zhavor, gjithashtu ai nuk ka as ujë të mjaftueshëm për pije dhe furnizim si dhe nuk ka rrjet të kanalizimit, kërkesat ia ka adresuar komunës dhe të njëjtat mi ka sjellë edhe mua por si e ka parapa DPUMM rregullimin e kësaj rruge unë nuk e di. Këto kërkesa mu kanë adresuar mua përkundër faktit se e kam njoftuar se ne do bisedojmë sot në mbledhje lidhur me kërkesat e tij por ne nuk jemi kompetent në vendimmarrje se dihet që drejtoritë përkatëse janë përgjegjëse për këto çështje.

z.Liman Zeqiri -shef i Zyrës Komonale për Komuniteteve dhe Kthim ZKKK, theksoi, dihet se zotëria në fjalë është përfitues i shtëpisë dhe është mirë që ka përfituar dhe duhet me qenë shumë i kënaqur me projektin që ka përfituar, sa i përket çështjes së infrastrukturës ne kemi kërkuar që të hapet ajo rrugë dhe të bëhet rregullimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe të shtrohet ajo rrugë me zhavor, këto kërkesa ai duhet t'i dorëzoj në DSHPMSH, DPUMM merret me asfaltimin e rrugëve do të thotë DSHPMSH, ka tjera kompetenca që merret me hapjen e kanaleve, rregullimin e kanalizimeve, ujësjellësi është çështje tjetër se është kompani profitabile që së bashku me energjinë elektrike janë të ndara prej komune dhe është mirë që këto koordinohen dhe bashkëpunojnë mes veti por me këto kërkesa ai duhet t'i drejtohet me shkrim DSHPMSH-së. Ne si zyre mund të shkojmë e të interferojmë kur mendojmë se duhet ndihmuar për ato punë që i kemi obligim.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, faleminderit i nderuar sa për sqarim ai kërkesat i ka bërë dhe një kopje ma ka dhuruar edhe mua edhe atë ditë kur ishte prezent drejtori shumë qartë na ka treguar që duhet parashtruar kërkesat se pa pas kërkesë askush nuk e din se çfarë problemi ke, por zotëria në fjalë nga unë kërkoj që kërkesat e tij të diskutohen edhe në këtë mbledhje të komitetit dhe unë iu përgjigja se këto kërkesa ne do i diskutojmë por sa do kemi mundësi të ndihmojmë është çështje tjetër. Atë që e cekët ju z.Liman Zeqiri atë na e ka thënë edhe drejtori në takimimin e mëparshëm dhe nuk kemi çka të diskutojmë më shumë për këtë çështje.

Meqë nuk kishte të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komiteti e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:46

**Procesverbalin e mbajti,
Osman Bajrami**

**Nr.Prot.01-060/04-0061112/24
Podujevë, 06 shtator 2024**

**Kryesuesi i Komitetit
Xhafer Ademi**